

## Oral History Kosovo

---

**Narratorja:** Në depresion jom konë meniherë mas lindjes të djalit, domethonë djali m’i ka bo gjashtë mujë, masi m’i ka bo djali gjashtë mujë i kom pasë në shpi të burrit dy vdekje. U konë gjyshja vet, u konë me neve në shpi edhe u konë mixha i tina. Domethonë, jonë dekë brenda dy jave edhe e kom pasë une djalin e vogël edhe qaq shumë, domethonë niherë njona deke edhe si nuse domethonë s’di u pata trishtu se mu nuk më ka ra me pa, a din, me pasë deke në familje.

Edhe u pata tutë diqysh edhe kur ndodhi edhe vdekja e dytë njerëzit aty tregojshin sene të trishtushme, ngjarje edhe pata hi në depresion. Jom konë në depresion shumë keq, jom shku nëpër çdo mjek, jom shku te psikologët, gjithkunj. E kom pasë djalin në gji thojshin, “Hiçe djalin prej gjinit”. Po diqysh kurrë nuk e kom pranë ato me përdorë terapi. Niherë ma kanë dhonë ni terapi, kom provu me përdorë. Amo hapin e parë që e kom pi, domethonë tri ditë nuk m’u ka nalë kurrë kryt, une nuk kom mujt m’u çu prej kauqit edhe mo. Kom thonë nuk e pi.

Veç me ni hap e kom pasë qat dhimtje të kresë. Edhe kom thonë, “Jo, kom m’u munu me gjithë forcat me kalu”. Forca e vetme që ma ka dhonë u konë djali jem. Domethonë, u konë, kur e kom pasë sikletin ma të madh, sa herë e kujtoj këto prekna, sikletin ma të madh kur jom konë sa herë e kom kap ato afër më ka dhonë forcë diqysh (i dridhet zëri). Shumë forcë sa, nuk e di, edhe thojsha veç për to kom me jetu. Gjithmonë e kom pasë atë frikën se nesra kom me dekë (qan), nuk kom m’u konë gjallë. Edhe më rroke si munim, si siklet, nuk e di as nuk muj me përshkru me fjalë atë ndjenjë që e kom pasë.

Domethonë, e kom pasë atë ndjenjë diku afër gjashtë mujë. Ni mujë kom nejt veç te nana, nuk kom mujt me shku te burri hiç, se në momentin që kom hi në atë shpi, veç thojsha kur të më dalin mentë prej kresë. Edhe ni mujë kom nejt veç te nona me djalin, për qata jom shumë e lidhtë edhe më dhimët për gjithçka, se në momente kur kom pasë ma së shumti nevojë ai diqysh më ka forcu gjithë.

Edhe sot gjithë e ruj edhe kaniherë thom duhet edhe ai nashta, thojsha e kom ushqy me tomël qat depresion edhe djali osht’... me tomël gjinit po du me thonë, edhe djali osht’ gjithmonë ma si në siklet si... diqysh hala e ka atë ndjenjën, nuk është ni fëmi, osht’ shumë i urtë, tepër, amo tutët p’i çdo senit. Domethonë, në kohën kur vdiq babgjyshi para dy vjete, e kom pasë edhe djalin ashtu diçka u konë amo fëmi ai nashta s’ka ditë me spjegu a dinë bash çka ka. Nashta edhe ai u frikësu se nuk e ka pa as kurgjo, kom ardhë mas tri dite, po e lypke babgjyshin tem se e ka dashtë shumë.

Edhe ke në moshën atëherë në klasë të parë amo i kuptojke tash pak a shumë do sene edhe natën ratë u çojke ma bojke, “Oj mam, a ki me dekë ti si baci?” Se qashtu e ka thirrë babgjyshin. Ja bojsha, “Jo mamit, jo, njerëzit kur të plaken desin”. E burri me punë, e pat çu puna nja ni javë në Gjermani për ni

trajnim borovnicav në qat kohë edhe pata nejt ni javë te nona. E si vike prej shkollës thojke, “Mam, po du me dalë me ble ni lojë, po du me dalë me ble ni lojë” a din, kajke. Edhe thojsha, “Hajde dalum e blejna”. Si dilsha prej dyrve të oborrit isha veç me to.

Ja bojsha, “Lon, mam, a dashte me ble përnime lojna, a dashte veç me dalë?” “Oj mam, veç dashta me dalë prej shpisë se po më vjen me kajt, a ki me dekë ti?” Domethonë, nonstop edhe i kish pasë hi në kry djalit qajo. Nonstop shkojshim te dytë t’u kajtë, ka u kthejke ai u mashtrojke me lojnë, unë u kthejsa t’u kajt apet. Edhe më dhimke qitu, nifarë dhimte edhe vet me veti thojsha, thojsha, “Nëse des, ça bon ky?” A din, qaq më hini edhe m’u tuta, qaq e madhe, çdo ditë mëngjes kur u çojsha e preksha veten, a jom gjallë, a jom dekën?

Deri sa e pashë ni andërr që nashta ma çoi edhe Zoti (qesh), pashë ni ondërr ni natë fluturova, fluturova edhe rashë me ni gropë me dhe edhe djalin diqysh e pata në dorë edhe si melaqet ma bojshin, “Me të marr me veti”. Ja bojsha, “Moni se djali jem tranohet, nuk munët me jetu, se pa mu ky ka m’u çmend”. Dikur melaqja, kishe tjetra i tha, “Lene se nuk i rrijnë kësaj fëmija, se nuk mujnë me përballu”. Edhe u largun edhe më ka dalë gjumi në qato momente, prej atij momenti m’u ka largu krejt ajo trema. Nashta edhe Zoti ma çoi pak me ma largu atë farë vesin e keq. Amo qeto jonë konë dy periudhat ma të fshtira, se njeri çdo sen p’e përballojke, amo depresioni ish shumë i keq.